

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Në këtë seancë plenare maratonë po diskutohet projektligji për miratimin e marrëveshjes kuadër në lidhje me projektin e investimit strategjik “Marina dhe jahtet e Durrësit”. Së pari, vlen për t’u shprehur interesi që qeveria propagandon për Durrësin, ndërkohë që në dy mandatet e fundit nuk ka bërë gjysmën e asaj që reklamon se ka bërë. Ndoshta duhet ta nisim edhe një herë nga plehrat. Plehrat ndodhen në çdo cep të qytetit të Durrësit. A doni të flisni për Agjencinë e Emergjencave Civile? Mos vallë duhet t’jua rikujtoj se u përpoqët t’i asistonit viktimat e tërmetit me ekskavatorë?! E kthyet Shqipërinë në vendin e botës së tretë brenda 24 orëve!

Ju lutem, të nderuar kolegë, na i kurseni elozhet qeveritare! E kuptojmë që nuk keni asgjë për të na treguar për Durrësin, se historinë e Durrësit e betonuat, e groposët, ndërtuat pallate mbi rrënojat historike dhe tani vini këtu e justifikoheni se keni plane të mëdha për të ardhmen! Patjetër që Durrësi është një qytet me vlera të panumërta dhe, si i tillë, duhet të kishte vëmendje që i takon, por qeveria vjen sot me pyetjen se përse ne nuk jemi pro projekteve që ajo paraqet. Drejtuat akuza të shëmtuara ndaj opozitës, se ne nuk pranojmë kurrsesi që një marrëveshje dhe një projekt i kësaj rëndësie të kalojë me procedurë të përshpejtuar, duke zhvlerësuar punën e këtij Kuvendi dhe të këtyre komisioneve për një projekt me vlerë 2,1 miliardë euro.

Kuptohet që 2,1 miliardë euro nuk janë asgjë për ju, mund t’i kaloni me procedurë të përshpejtuar dhe të anashkaloni ligjin vetëm për të arritur të bëni reklamën për të cilën keni nevojë. Projektligji u depozitua në Kuvend në datën 08.11.2022, dhe dy ditë më vonë qeveria e kaloi në Kuvend për shqyrtim me procedurë të përshpejtuar. Çfarë mendojnë vallë qytetarët e Durrësit për këtë? Besoj se mendojnë se si do t’ia dalin të përballojnë dëmet e përmbytjes, se u ka ardhur uji deri në grykë dhe, fatkeqësisht, nuk kanë mundësi ta shqyrtojnë këtë marrëveshje të artë! Nëse akuzoni opozitën se ju gjykon për mungesë transparence, çfarë keni për të thënë për BE-në, e cila cilëson se nuk do ta investojë shumë e premtuar, pasi qeveria shqiptare nuk po tregon transparencë?

U tërhoq financimi prej 28 milionë eurosh i BE-së. Komisioni Europian është shprehur në të paktën dy raste kundër miratimit të projekteve me ligj special, pasi synonte parimet e konkurrencës dhe të

mosdiskriminimit. Ligjet tuaja speciale u ofrojnë mbrojtje çdokujt përveç qytetarëve, se për Kryeministrin është e paprecedent që të mbrohet qytetari, duke u nisur edhe nga deklaratat në seancën e sotme, ku theksoi se ishte e palogjikshme të shpallej gjendja e fatkeqësisë natyrore për 30 shtëpi. Është e pabesueshme! Nuk besoj se ka nevojë për më shumë shpjegime për mënyrën se si operon kjo qeveri sot.

Për t'u kthyer te projekti, ky projektligj bie qartazi në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës dhe nenet 71 dhe 74 të MSA-së, ku garantohen, përkatësisht, mbrojtja e pronës private dhe publike, si dhe konkurrenca e ndershme. Është e qartë se në rastin konkret nuk mbrohet interesi publik, përkundrazi, cenohet rëndë. Viojnë pyetjet: si do të zhvendoset porti i sotëm; sa do të kushtojë kjo zhvendosje? Transferimi i portit aktual në Porto Romano është një shqetësim i shtuar. Relacioni nuk përmban shpjegime sa i përket detajimit të zërave sipas vlerës totale të investimit.

Sipas qeverisë, opozita thotë "jo" për çdo gjë, ndërkohë e njëjta qeveri shfaq gjithmonë të njëjtën taktikë shmangieje, si shembulli i ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion për projektin e rrugës ThumanëKashar, ku shpronësimet po bëhen në kundërshtim me standardin e pronës në vlerën e tregut. Për këtë shkak ju sugjeroj që, si fillim, të bëni punën tuaj, siç e përcakton ligji dhe ta respektoni atë, sepse sot po luani me fatin e mijëra qytetarëve. Si deputete e qarkut të Durrësit, këto çështje më shqetësojnë realisht, sepse ku nuk ka transparencë, nuk besoj se ka drejtësi dhe llogaridhënie.

Është e papranueshme që deputetët e maxhorancës të cenojnë integritetin e këtij qarku, ku vazhdimisht fshihen informacionet dhe sulmohet opozita, vetëm e vetëm se precedenti juaj tregon që jeni ekspertë në shtrembërimin e ligjit. Mungesa e plotë e transparencës, e konsultimit me qytetarët, arroganca dhe shpejtësia, nëpërmjet të cilave qeveria po përpiqet ta miratojë këtë marrëveshje, janë dëshmi e qartë e mungesës së guximit për t'u përballur me problematikat e mëdha që paraqiten. E kuptojmë se nuk keni argumente, e kuptojmë se ndoshta dridheni, por ju kërkoj edhe një herë të na e kurseni arrogancën dhe këtë shfaqje të shëmtuar teatrale! Faleminderit!